

E nderuar znj. Schutz,
Të nderuar miq e të ftuar,

Kam kënaqësinë t'ju kem sot këtu, në këtë ceremoni të thjeshtë e domethënëse të dhurimit të infrastrukturës digjitale nga Ambasada Gjermane në Tiranë, për arkivin e dëshmime gojore të AIDSSH-së. Bashkëpunimi i nisur me Ambasadën Gjermane është i hershëm dhe ka provuar të jetë i qëndrueshëm. I falënderojmë.

Jam e kënaqur që pas një viti, projekti i dëshmime gojore, i lançuar më 20 shkurt 2018 në Tiranë dhe i zbatuar në të gjithë vendin, me regjistrimin e rrëfimeve të mbijetuarve të përndjekjes e çnjerëzimit dhe bashkëbisedimet e hapura në universitete arriti të materializohet në produkte konkrete:

-një uebfaqe me emrin Edhe muret kanë veshë, platformë komunikimi përmes dëshmime të dhimbjes e mbijetesës;

-një libër me dëshmitë e të mbijetuarve të Kampit të Tepelenës, i cili do të pasohet nga vëllime të tjera;

-një marrëveshje me Zërin e Amerikës, që në bashkëpunim me Federatën Vatra ndihmojnë në mbledhjen e dëshmime gojore të bashkësisë shqiptare në Amerikë;

-dhe plotësimi i pajiseve për realizimin e plotë të intervistave e regjistrimeve në vend, pra, në mjediset e Autoritetit dhe në mbarë Shqipërinë, nëpërmjet seteve lëvizëse, që na lejojnë të shkojmë pranë të mbijetuarve dhe t'i regjistrojmë në vendet ku jetojnë.

Vit i gjatë, punë të mëdha, më shumë hapa drejt së vërtetës, më shumë detyrime të përmbushura ndaj shoqërisë, të rinjve dhe brezave që do të vijnë.

Në këtë kuadër, këtë fillimvit, si AIDSSH vijojmë sot projektin e nisur më parë me partnerë, "Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar", me mbështetjen e PNUD në Shqipëri dhe Qeverisë së Italisë, ku AIDSSH dhe dy artiste shqiptare nga Britania, me mbështetje lokale, institucionale dhe njerëzore, ndërmorën sfidën e regjistrimit të dëshmime gojore në vend, të ruajtjes dhe zbardhjes së tyre; publikimit dhe shpërndarjes për të interesuarit.

Formati i pyetjeve u zhvillua me këshillën e studiuesve nga Instituti i Historisë dhe AIDSSH. Transkriptimi u bë në zyrat e AIDSSH, ku dhe ruhen rrëfimet e regjistruara me zë dhe figurë. Në dukje e thjeshtë, kjo është punë shumë voluminoze dhe e kujdesshme, dhe AIDSSH falënderon të gjithë kontribuesit, por sidomos të mbijetuarit që, ndonëse në pjesën më të madhe kanë moshë të thyer, na i besuan me durim kujtimet e tyre të dhimbshme.

Kjo qasje e drejtpërdrejtë në të shkuarën, që sjell me përgjegjësi histori të rrëfyera nga njerëz të njohur e të panjohur, këto zëra, emra dhe personalitete, janë mundësi për ta zbuluar të shkuarën përmes atyre që e jetuan, e përballuan, i rezistuan apo u drobitën nga pesha e saj.

Por dialogu shoqëror që synojmë të edukojmë e zhvillojmë për të shkuarën mund të realizohet vetëm nëpërmjet kësaj hapjeje e dokumentimi. Sepse është përballja me të vërtetën ajo që e çon shoqërinë drejt shërimit dhe rivendos ekuilibra. Kjo përballje nënkupton edhe zbardhjen e fateve të të pafajshmëve dhe nderimin i sakrificës së atyre që ia dolën me dinjitet njerëzor, duke njohur përjetimet e tyre, përmes zërave të tyre. Ky është hapi i rëndësishëm që hedhim sot.

Kujtesa historike është në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive. Ajo luan rol në ndërtimin e raporteve mes grupeve të ndryshme të shoqërisë. Mungesa e saj mund të jetë edhe burim i tensioneve apo konflikteve. Iniciativa të tilla të përkujtimit, dokumentimit historik e më gjerë,

të gjitha bashkë luajnë rol në krijimin dhe zhvillimin e një pikëpamjeje historike të individëve e grupeve të caktuara dhe janë mjete komunikimi të diskutimit lokal apo kombëtar a më gjerë.

Tashmë, këto dëshmi do të administrohen me kujdes dhe do t'i vihen në dispozicion çdo studiuesi, në çdo kohë, sipas rregullave të arkivave në Republikën e Shqipërisë dhe vullnetit të qytetarëve që na kanë besuar rrëfimet, përmes marrëveshjes që kanë nënshkruar me intervistuesin. AIDSSH merr përsipër të administrojë dhe ruajë këto regjistrime, me standardin e një arkivi të vyer historik e i jep një shans më shumë mbështetjes së kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, krahas qasjes së papenguar në dokumentet e Sigurimit të Shtetit në diktaturë.

“Tregimi im, është detyrim moral për prindërit e mi, për veten time, për ju o bij, për bashkëvuajtësit e mi dhe për shoqërinë,” shprehej një nga të mbijetuarit që dëshmoi kalvarin e vet gjatë diktaturës. Pikërisht ky është motivi që na shtyn përpara në punën tonë.

Ju faleminderit!